



YOUR REFERENCES FOR TAX NEWS IN ALBANIA

December, 2021

AEcO Business Solutions has created the Tax Newsletter, covering the period from August to December 2021 with the aim of providing both local and international businesses with answers to key questions regarding tax regulations in Albania



1.

Është miratuar Ligji i Ri për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse në Shqipëri

Sipas ligjit të ri të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, për regjistrimin elektronik të organizatave jofitimprurëse, organizatat dhe fondacionet duhet të deklarojnë të dhëna të detajuara mbi pasqyrat e tyre financiare, themeluesit, veprimtarinë, vendndodhjen dhe vlerat pasurore.

Po ashtu do të krijohet një regjistër elektronik i OJF-ve, me të gjitha të dhënat e detajuara dhe të përditësuara rreth tyre, i cili do të administrohet nga Gjykata e Tiranës.

Miratimi i këtij ligji të ri ka qenë një prej kërkesave të MONEYVAL për Shqipërinë, në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave.

2.

Fiskalizimi – Fillimi i lëshimit të faturave elektronike të fiskalizuara për B2C prej 1 shtatorit

Me hyrjen e datës 1 shtator 2021, të gjithë tatimpaguesit, të cilët janë subjekt i Ligjit nr. 87/2019 për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit, duhet të lëshojnë vetëm fatura elektronike të fiskalizuara.

Për tatimpaguesit që kryejnë transaksione me para në dorë (B2C), kanë filluar të zbatohen rregullat e fiskalizimit për transaksionet me cash, e cila ishte fasha e fundit e mbetur pa u përfshirë në procesin e fiskalizimit.

Tatimpaguesit, të cilët ende nuk kanë aplikuar për Certifikatë Elektronike ose nuk janë pajisur me një zgjidhje software-ike duhet të pajisen me një të tillë për të shmangur penaltetet specifike sipas Ligjit për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë.



3.

Fiskalizimi – Tatimpaguesit që kryejnë transaksione business to business (B2B)

Më dt. 31.08.2021 mbaroi afati i fundit i lejuar për tatimpaguesit B2B për faturimet e shitjeve të mallrave dhe shërbimeve me bllokun fizik. Nga data 1 shtator subjektet duhet të fillojnë faturimet vetëm me anë të procesit të fiskalizimit dhe me bllokun e veçantë në rast problemesh të caktuara. Në të kundërt **Faturat e lëshuara të pafiskalizuara pas datës 1 Shtator 2021, nuk do të njihen për efekt shpenzimesh.**

4.

Njoftim mbi përdorimin e dokumentacionit ekzistues tatimor (blloku fizik)

Administrata Tatimore ka njoftuar se do të bëjnë përjashtim deri më 31.12.2021 (pra do të njihen për efekt shpenzimesh), vetëm ato fatura të lëshuara në format të pafiskalizuara, për arsye që nuk varen nga tatimpaguesi.

Në zbatim të Ligjit Nr. 87/2019, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", çdo tatimpagues ka detyrim ligjor të lëshojë vetëm fatura të fiskalizuara. Në të kundërt këto fatura nuk do të njihen për efekt shpenzimesh pas datës 1 Shtator 2021 nëse:

- Tatimpaguesi nuk ka kryer ende aplikimin për Certifikatë Elektronike të Fiskalizimit
- Tatimpaguesi nuk ka lidhur një kontratë me një shoqëri software-ike për programin që do të përdorë në lëshimin e faturave.

DPT njofton se dy dokumentet e mësipërm justifikues duhet të ngarkohen në llogarinë e-filing të biznesit.

TAX CONSULTANT



5.

Si ndikon në Procesin e Fiskalizimit, ndryshimi i të dhënave të subjektit në QKB?

Sipas njoftimeve nga Administrata Tatimore, në rastet kur një tatimpagues bën kërkesë për ndryshim të të dhënave të subjektit (tashmë kryhet online ne portalin e-albania), duhet të verifikojë Kodin e Vendit të ushtrimit të aktivitetit në portalin SelfCare të fiskalizimit.

Pranimi i kërkesës nga QKB për ndryshim shoqërohet me një CN Case number të ri (një numër të ri çështjeje) dhe kjo reflektohet në Sistemin Tatimor duke gjeneruar një Kod të ri të Vendit të Ushtrimit të Aktivitetit.

Duke qenë se Kodi i Vendit të Ushtrimit të Aktivitetit është një nga të dhënat kyçe për t'u regjistruar në portalin SelfCare të fiskalizimit, dhe që i lejon biznesit të lëshojë fatura, atëherë duhet që tatimpaguesi të njoftojë ofruesin e zgjidhjes software-ike për Kodin e Ri. Ofruesi i programit kryen përditësimet e duhura për të mundësuar lëshimin e faturave nga biznesi.

6.

Librat e Shitjes dhe të Blerjes do vijojnë të dorëzohen nëpërmjet sistemit të e-filing

Dorëzimi i librave të shitjes dhe blerjes do të vijojë të kryhet me anë të llogarisë së biznesit në e-filing, sipas mënyrës që është përdorur deri më tani.

Afati për përdorimin e sistemit e-filing në deklarimin e librave u shty fillimisht deri në Dhjetor 2021 dhe në një njoftim të dytë u vendos të shtyhen deri më 30.06.2021.

Plotësimi i rubrikave të librave do të kryhen manualisht, duke përfshirë të dhënat e faturave të fiskalizuara dhe atyre të lëshuara nga blloku fizik i dokumentacionit tatimor.



7.

Përrjashtim për ndërtesit, nga tatimi 15% i fitimit kapital të realizuar nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme

Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës kanë publikuar një udhëzim të përbashkët në Fletoren Zyrtare dt. 14.10.2021, ku shprehet se nuk do të jenë subjekte “të tatimit mbi të ardhurat personale” nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme grupet e mëposhtme:

- a) Sipërmarrësit (ndërtesit) në fushën e ndërtimit, të pajisur me NIPT, pavarësisht nga statusi (“person fizik” apo “person fizik tregtar”), të cilët ndërtojnë për qëllim shitjeje;
- b) Investitorët në fushën e ndërtimit, të cilët financojnë produktin e ndërtimit me qëllim shitjeje, në rastet kur janë të regjistruar në QKB (janë të pajisur me NIPT) dhe u është caktuar përgjegjësia tatimore.

Por, këto grupe do të vijojnë të jenë pagues të “taksës” vendore mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, sipas parashikimeve në nenin 28, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.



WHAT TO EXPECT AFTER
JANUARY 1ST, 2022?

Ndryshimet në paketën fiskale 2022

8.

Ndryshime në Ligjin “Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” për vitin 2022

Masat e reja të politikës fiskale konsistojnë në:

- Trajtimin me shkallë të reduktuar të TVSH-së prej 10% të furnizimit të inputeve bujqësore, siç janë:
 - plehrat kimike,
 - pesticidet,
 - farat dhe fidanët, përveç hormoneve të klasifikuara në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave
- Përfshirjen nga TVSH-ja për importimin e makinerive dhe të pajisjeve në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë të barabartë ose më të madhe se 500 milionë lekë (nga 50 milionë lekë që ishte më parë)
- Gjithashtu, importimi i makinerive prodhuese nga subjektet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin shfuqizohet nga lista e përjashtimeve të veçanta në import.
- Zëvendësimin e normës së kompensimit të prodhuesit bujqësor prej 6% në 0%.



WHAT TO EXPECT AFTER
JANUARY 1ST, 2022?

Ndryshimet në paketën fiskale 2022

9.

Shtesa në Ligjin “Për Taksat Kombëtare”

Në vitin 2022 do të aplikohen taksa kombëtare për disa lloje të reja produktesh si në vijim:

- Taksë për qumështin pluhur për tregti, në vlerën 100 lekë për kg.
- Taksë për pijen e homogjenizuar barista në vlerën 16 lekë për litër.
- Taksë për hurrë qumështi në vlerën 150 lekë për kg.
- Taksë për krem qumështi në vlerën 150 lekë për litër.
- Taksë për karburantin në zonat e lira doganore dhe magazinat doganore që përdoret për furnizimin e mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtim, në vlerën 65 lekë/litër.

Do të përjashtohen nga pagimi i taksës për qumështin pluhur, taksës për hurrë qumështi dhe taksës për krem qumështi fabrikat e prodhimit me etiketë të miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.



WHAT TO EXPECT AFTER
JANUARY 1ST, 2022?

Ndryshimet në paketën fiskale 2022

10.

Ndryshim në Ligjin “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, me efekt nga data I Korrik 2022

Ndryshon përlogaritja e Tatimit mbi të Ardhurat Personale nga punësimi:

- Rritja e pagës dysheme të patatueshme për të ardhura deri në 40,000 lekë/muaj
- Për paga më të larta, tatimi ndryshon sipas tabelës në vijim

E ardhura nga Paga (lekë/muaj)		E ardhura e tatueshme (lekë/muaj)		Norma tatimore %/mujore
Nga	Deri në	Nga	Deri në	
0	40,000	0	40,000	0%
40,001	50,000	0	30,000	0%
		30,001	50,000	50%*13% të shumës mbi 30,000 lekë
50,001	Më tepër	0	30,000	0%
		30,001	200,000	13% e shumës mbi 30,000 lekë
		200,001	Më tepër	22,100 lekë + 23% të shumës mbi 200,000 lekë

11.1

Ndryshime dhe shtesa në Ligjin “Për Akcizat”

Ligji për akcizat ka pësuar një sërë ndryshimesh në paketën e re fiskale 2022.



WHAT TO EXPECT AFTER
JANUARY 1ST, 2022?

- Vendosja e akcizës së gazit në 6 lekë/litri nga zero që është aktualisht për gazin që përdoret nga bizneset (më parë taksohej vetëm gazi që përdorej për automjete), i cili ndikon në ato fabrika që përdorin gazin si lëndë djegëse për të prodhuar.

Ndryshimet në paketën fiskale 2022

Kategoria	Kodi NK	Përshkrimi	Shkalla taksimit me Akcizë
E 500 Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike	27111211	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim si lëndë djegëse për motor automjetesh	8 lekë/litri në 1 janar 2022 deri 1 korrik 2022
	27111219		
	27111291		
	27111293		
	27111294		
	27111297	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim të ndryshëm nga ai si lëndë djegëse për motor automjetesh.	0 lekë/litri në 1 janar 2022 deri 1 korrik 2022
	27111310		
	27111330		
	27111391		
	27111397		
27111400	6 lekë/litri nga 1 korrik 2022		

- Heqja e rimbursimit të akcizes për lëndët djegëse të konsumuara në serat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë (farmaceutika, tullat, çimento, birra dhe nafta bruto).
- Rritja graduale çdo vit e akcizës për të gjithë kategoritë e “Duhan dhe nënprodukteve të tij”

11.2

Ndryshime dhe shtesa në Ligjin “Për Akcizat”



WHAT TO EXPECT AFTER
JANUARY 1ST, 2022?

Ndryshimet në paketën fiskale 2022

Ndryshime të tjera kanë qëllim heqjen e mbikëqyrjes së detyruar me prezencë fizike të autoriteteve doganore në procesin e vendosjes së pullave të akcizës, dhe zëvendësimin e tyre me mbikëqyrje me kamera.

- Autoriteti doganor kur e vlerëson të arsyeshme mund të ushtrojë edhe prezencën fizike.
- Tepricat ose mangësitë në pulla fiskale, të konstatuara gjatë kontrollit të magazinave fiskale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë nga 20.000 lekë deri në 50.000 lekë.
- Mos mbajtja, mos ruajtja si dhe mosdhënia e regjistrimeve/kontabilitetit, sipas kërkesës së organeve doganore, dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë (nga 500 000 lekë që ishte më parë)
- Tepricat ose mangësitë në pullat fiskale mbi 2% të sasisë kontabël të llogaritur për periudhën objekt kontrolli, të konstatuara gjatë kontrollit të operatorëve ekonomik, të cilët nuk janë depozitues të miratuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë sipas Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë,



12.

Tatimpaguesit qe perjashtohen nga leshimi i faturave te fiskalizuara

Tatimpaguesit të cilët përjashtohen nga detyrimi për të lëshuar dhe fiskalizuar fatura për furnizimet që kryejnë janë:

- i. prodhuesit bujqësorë
- ii. tatimpaguesit që ofrojnë shërbimin taksi të pajisur me taksimetër
- iii. tatimpaguesit që shesin bileta ose abone për transport pasagjerësh në sektorin e transportit publik urban brenda qytetit
- iv. shitësit e regjistruar si "ambulantë"

13.

Shtyhet aplikimi i gjobave për kundërvajtjet administrative që lidhen me zbatimin efektiv të ligjit për Fiskalizimin, deri më datë 30.06.2022

Shtyrja e gjobave është e vlefshme vetëm për grupet e mëposhtme:

- Subjektet e regjistruara për tatim të thjeshtuar mbi fitimin dhe që nuk janë të regjistruar për TVSH-në, të cilët kryejnë vetëm shitje me para në dorë kundrejt konsumatorëve finalë.
- Tatimpaguesit që ofrojnë furnizimin me ujë për konsumatorët finalë, si dhe tregu i rregulluar i energjisë elektrike.
- Bankat apo institucionet financiare për njoftimin e pagesave të e-Faturave të lëshuara nga subjektet tatimpaguese

14.

Regjistrimi i faturave në librin e shitjes dhe librin e blerjes për shërbimet e vazhdueshme

Sipas ndryshimit të fundit në udhëzimin Nr. 16/2020, "Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit" që ka të bëjë me regjistrimin në librin e shitjes dhe librin e blerjes të faturave të cilat lëshohen në mënyrë të vazhdueshme (ujë, drita, internet, sigurim etj.), të gjithë tatimpaguesit blerës duhet të sigurohen për të përditësuar/saktësuar të dhënat e tyre në kontratën mbi të cilën bazohet furnizimi.

Për sa më sipër, faturat e fiskalizuara nga subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushën e telekomunikacionit, sigurimeve, furnizimit të energjisë elektrike dhe ujit për konsumatorët finalë, si dhe faturat mujore të lidhura me kontrata afatgjata leasing dhe fatura të ngjashme me to, të cilat lëshohen në mënyrë të vazhdueshme dhe mbi bazën e një kontrate afatgjatë të lidhur paraprakisht nga palët, do të çmohen të fiskalizuara automatikisht pavarësisht statusit të blerësit.



15.

Ligji i ri “Për të Huajt”

Ligji i ri për të huajt parashikon shfuqizimin e ligjit të mëparshëm të miratuar në vitin 2013 duke parashtruar përgjegjësi më të qarta në lidhje me detyrimet që kanë autoriteteve përgjegjëse për të respektuar të drejtat kushtetuese të të huajve apo atyre që kërkojnë të punësohen, apo të qëndrojnë në Shqipëri.

Ky ligj synon përmirësimin e mekanizmave të nevojshëm për lëshimin e vizave elektronike online, me qëllim integrimin e lejes unike, Kjo leje do të sjellë ndryshime thelbësore duke garantuar një procedurë të vetme aplikimi, për një “leje të vetme”, për të huajt që synojnë të punojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Leja e punës, tashmë do të referohet me termin e ri “leje unike”, ku gjithashtu gjenden të parashikuar llojet e lejeve unike, procedurat e përfitimit të lejes unike si dhe ankimet, po ashtu parashikohet leja unike për kategori të vecanta.

16.

Ndryshime në Ligjin “Për Noterinë”

Ndryshimet e reja ligjore synojnë përmirësimin e disa aspekteve që kanë të bëjnë me integritetin dhe besueshmërinë e profesionale të noterëve. Shtesat synojnë ushtrimin e një kontrolli më të mirë të personave që janë mbajtës së licencës së noterit si dhe marrjen e masave për heqjen e saj në rast se konstatohet mospërbushje e kushteve.

Në rast se noteri ka kontakte të papërshtatshme me një person të përfshirë në krimin e organizuar ose në kryerjen e veprave të rënda penale, ministri i Drejtësisë urdhëron inspektime të rregullta në vend për të gjitha aktet, regjistrin e veprimtarisë noteriale si dhe çdo dokumentacion tjetër të aktivitetit noterial jo më pak se 1 herë në vit. Noteri i nënshtrohet inspektimit me intervale të rregullta, jo më vonë se dy vjet nga data e kontaktit të fundit të papërshtatshëm.



1.

The New Law on Registration of Non-Profit Organizations in Albania has been adopted

According to the new law approved for the electronic registration of non-profit organizations by the Albanian Parliament, organizations and foundations must declare detailed data on their financial statements, founders, activity, location and property values.

An electronic register of NGOs will also be established, with all detailed and updated data about them, which will be administered by the Court of Tirana.

The adoption of this new law has been one of the demands of MONEYVAL for Albania, in the framework of the fight against money laundering.

2.

Fiscalization - Start of issuance of fiscalized electronic invoices for B2C from September 1

With the entry of September 1, 2021, all taxpayers, who are subject to Law no. 87/2019 "On the Invoice and the Turnover Monitoring System" should issue only electronic fiscalized invoices.

For taxpayers of cash transactions (B2C), the fiscalization rules have started to be applied, as the last group left uninvolved in the fiscalization process.

Taxpayers who have not yet applied for an Electronic Certificate or have not been provided with a software solution must be provided with one to avoid specific penalties under the Law on Tax Procedures in the Republic of Albania.



3.

Fiscalization - Taxpayers conducting business to business (B2B) transactions

On 31.08.2021 the deadline allowed for B2B taxpayers for invoicing sales of goods and services with the physical block has expired. From September 1, entities must start billing only through the fiscalization process and with the special blocks in case of certain problems. Otherwise, **Invoices issued unfiscalized after September 1, 2021, will not be recognized for fiscal purposes.**

4.

Notice on the use of existing tax documentation (physical block)

The Tax Administration has announced that they will make an exception until 31.12.2021 for the expenditures regarding non-fiscalized invoices to be known as deductible expenses only in cases when the reasons for not adopting the new law do not depend on the taxpayer directly.

Pursuant to Law no. 87/2019, "On the Invoice and the Turnover Monitoring System" every taxpayer has a legal obligation to issue only fiscalized invoices. Otherwise, these invoices will not be recognized for expense effect after 1 September 2021 if:

- The taxpayer has not yet completed the application for Electronic Certificate of fiscalization
- The taxpayer has not entered into a contract with a software company for the program it will use in issuing invoices.

The GDT announces that the above two supporting documents must be uploaded to the business e-filing account.

TAX CONSULTANT



5.

How does the change of the subject data in the NBC affect the Fiscalization Process?

According to the notifications from the Tax Administration, in cases when a taxpayer makes a request to change the data of the entity (can be done online in the e-albania portal), he must verify the Code of the Place of Exercise of the activity in the SelfCare fiscalization portal.

Acceptance of the request by the NBC for change is accompanied by a new CN Case number (a new issue number) and this is reflected in the Tax System by generating a new Code of the Place of Exercise of activity.

As the Code of the Place of Exercise of activity is one of the key data to be registered in the SelfCare fiscalization portal, and which allows the business to issue invoices, then the taxpayer must notify the software solution provider of the new code. The program provider performs the necessary updates to enable the issuance of invoices by the business.

6.

The Sales and Purchase books will continue to be submitted through the e-filing system

Delivery of sales and purchase books will continue to be done through the e-filing business account, according to the way it has been used so far.

The deadline for the use of the e-filing system in the declaration of books was initially extended until December 2021 and in a second announcement it was decided to be postponed until 30.06.2021.

Completion of book sections will be done manually, including data on fiscalized invoices and those issued by the physical block of tax documentation.



7.

Exemption for construction companies, from tax 15% of capital gain realized from the transfer of real estate ownership

The Ministry of Finance and Economy and the State Cadastre Agency have published a joint instruction in the Official Gazette dt. 14.10.2021, which states that the following groups will not be subject to "personal income tax" from the transfer of ownership of immovable property:

- a) Entrepreneurs (builders) in the field of construction, equipped with NIPT, regardless of status ("natural person" or "commercial natural person"), who build for sale purposes;
- b) Investors in the field of construction, who finance the construction product for the purpose of sale, in cases when they are registered in the NBC (are equipped with NIPT) and have been assigned tax liability.

But, these groups will continue to be liable of the local "tax" on the transfer of ownership of immovable property, according to the provisions of Article 28 of Law no. 9632, dated 30.10.2006, "On the local tax system", as amended.



WHAT TO EXPECT AFTER
JANUARY 1ST, 2022?

Ndryshimet në paketën fiskale 2022

8.

Amendments to the Law "On Value Added Tax in the Republic of Albania" for 2022

The new fiscal policy measures consist of:

- Treatment with reduced VAT rate of 10% of the supply of agricultural inputs, such as:
 - chemical fertilizers,
 - pesticide,
 - seeds and seedlings, other than hormones classified under codes 2937 of the Combined Nomenclature of Goods
- Exemption from VAT for the import of machinery and equipment in order to implement investment contracts with value equal to or greater than ALL 500 million (from ALL 50 million previously)
- Also, the import of production machinery by the simplified profit tax subjects is abolished from the list of special exemptions in import.
- Replacement of the agricultural producer compensation rate from 6% to 0%.



WHAT TO EXPECT AFTER
JANUARY 1ST, 2022?

Ndryshimet në paketën fiskale 2022

9.

Additions to the Law "On National Taxes"

In 2022, national taxes will be applied for some new types of products as follows:

- Tax on milk powder for trade, in the amount of 100 ALL per kg.
- Tax for the homogenized barista drink in the amount of 16 ALL per liter.
- Tax for milk whey in the amount of 150 ALL per kg.
- Tax for milk cream in the amount of 150 ALL per liter.
- Tax on fuel in free customs zones and customs warehouses used for the supply of vessels for tourist and entertainment purposes, in the amount of 65 ALL / liter.

Production plants with a label approved by the National Food Authority will be exempted from paying the tax on powdered milk, the tax on milk whey and the tax on milk cream.



WHAT TO EXPECT AFTER
JANUARY 1ST, 2022?

Ndryshimet në paketën fiskale 2022

10.

Amendment to the Law "On Income Tax", effective from 1 July 2022

The calculation of Personal Income Tax from employment has changed:

- Increase of non-taxable minimal salary for income up to 40,000 ALL / month
- For higher salaries, the tax varies according to the following table

Salary income (ALL/month)		Taxable income (ALL/month)		Tax rate % / monthly
From	Up to	From	Up to	
0	40,000	0	40,000	0%
40,001	50,000	0	30,000	0%
		30,001	50,000	50% * 13% of the amount over 30,000 ALL
50,001	More	0	30,000	0%
		30,001	200,000	13% of the amount over 30,000 ALL
		200,001	More	22,100 ALL + 23% of the amount over 200,000 ALL

11.1

Amendments to the Law "On Excises"

The law on excises has undergone a number of changes in the new fiscal package 2022.

- Setting the gas excise tax at 6 lek / liter from zero, which is currently for gas used by businesses (previously only gas used for vehicles was taxed), which affects those factories that use gas as a fuel to produce.



WHAT TO EXPECT AFTER
JANUARY 1ST, 2022?

Ndryshimet në paketën fiskale 2022

Category	NK Code	Description	Excise tax rate
E 500 Petroleum gases and other gaseous hydrocarbons	27111211	Petroleum gases and other gaseous hydrocarbons for use as motor vehicle fuels	8 ALL / liter on January 1, 2022 until July 1, 2022
	27111219		
	27111291		
	27111293		
	27111294		
	27111297	Petroleum gases and other gaseous hydrocarbons for use other than as fuel for motor vehicles.	0 ALL / liter on January 1, 2022 until July 1, 2022
	27111310		
	27111330		
	27111391		
	27111397		
27111400	6 ALL / liter from July 1, 2022		

- Removal of excise refund for fuels consumed in heated greenhouses, for the production of industrial and agro-industrial products, which are used for technological needs of production in these sectors (pharmaceuticals, bricks, cement, beer and crude oil).
- Gradual increase every year of excise duty for all categories of "Tobacco and its by-products"

11.2

Amendments to the Law "On Excises"



WHAT TO EXPECT AFTER
JANUARY 1ST, 2022?

Ndryshimet në paketën fiskale 2022

Other changes are aimed at removing the mandatory physical surveillance of the customs authorities in the process of affixing excise stamps, and replacing them with camera surveillance.

- The customs authority may also exercise physical presence when it deems it reasonable.
- Excess or deficiencies in fiscal stamps, ascertained during the control of fiscal warehouses, constitute administrative contraventions and are punished with a fine from 20,000 ALL to 50,000 ALL.
- Failure to keep, maintain and not to provide records / accounting, at the request of customs authorities, is punishable by a fine of 50,000 ALL (from 500,000 ALL previously)
- Excess or deficiencies in fiscal stamps over 2% of the accounting amount calculated for the period under control, ascertained during the control of economic operators, who are not approved depositors, constitute administrative contraventions and are punished by a fine according to the Customs Code of the Republic of Albania.



12.

Taxpayers who are exempt from issuing fiscalized invoices

Taxpayers who are exempt from the obligation to issue and fiscalize invoices for the supplies they make are:

- i. agricultural producers
- ii. taxpayers who provide taxi service equipped with a taximeter
- iii. taxpayers selling tickets or season tickets for passenger transport in the urban public transport sector within the city
- iv. sellers registered as "ambulators"

13.

The application of fines for administrative offenses related to the effective implementation of the law on Fiscalization is postponed until 30.06.2022

Postponement of fines is valid only for the following groups:

- Entities registered for simplified profit tax and not registered for VAT, which perform only cash sales against final customers.
- Taxpayers providing water supply to final customers as well as regulated electricity market.
- Banks or financial institutions for notification of e-Invoice payments issued by taxpayers

14.

Recording invoices in the sales book and purchase book for ongoing services

According to the last change in instruction no. 16/2020, "On the Invoice and the Turnover Monitoring System" which has to do with the registration in the sales book and the purchase book of invoices which are issued continuously (water, electricity, internet, insurance, etc.), all purchasing taxpayers should update/specify their details in the contract on which the supply is based.

Regarding the above, the fiscalized invoices from entities operating in the field of telecommunications, insurance, electricity, and water supply for final customers, as well as the monthly invoices related to long-term leasing contracts and similar invoices, which are issued on an ongoing basis and on the basis of a long-term contract entered into in advance by the parties, will be deemed to be automatically fiscalized regardless of the status of the buyer.



15.

New Law “On Foreigners”

The new law on foreigners provides for the repeal of the previous law adopted in 2013, setting out clearer responsibilities regarding the obligations of the responsible authorities to respect the constitutional rights of foreigners or those seeking employment, or residence in Albania.

This law aims to improve the necessary mechanisms for issuing electronic visas online, in order to integrate the unique permit. This permit will bring substantial changes by guaranteeing a single application procedure, for a "single permit", for foreigners who intend to work and stay in the territory of the Republic of Albania. The work permit will now be referred to as the new term "unique permit", which also provides for the types of unique permits, procedures for obtaining a unique permit and appeals, as well as a unique permit for specific categories.

16.

Amendments to the Law "On Notary"

The new legal changes aim to improve some aspects related to the integrity and professional credibility of notaries. The additions aim at exercising a better control of the persons who are holders of the notary license as well as taking measures for its removal in case of non-fulfillment of the conditions.

In case the notary has inappropriate contacts with a person involved in organized crime or in committing serious criminal offenses, the Minister of Justice orders regular on-site inspections of all acts, the register of notarial activity and any other documentation of notarial activity not less than 1 time per year. The notary is subject to inspection at regular intervals, not later than two years from the date of last inappropriate contact.



CONTACT

AEcO Business Solution

Ibrahim Kodra str.
Bld. Hawai 2, Entr 1, Ap.18, 3rd floor

+355 68 403 9794

Tirane, Albania

Eriona Dobrovoda

edobrovoda@aeco-consulting.com

edobrovoda@aeco.al

This material has been prepared for general information purposes only and is not intended to be relied upon as accounting, tax, or other professional advice. Please refer to our advisors for specific advice.